



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-9898/20
Kaçanik, 27.05.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **III (Tretë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2020 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 27 Maj 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje janë 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye anëtarja, Afërdita Shehi.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale: Ukshin Qallaku, Ramadush Osmani, Fatmir Loku, Bahri Selimi, Diana Reka, Festim Neziraj dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës: Bejtulla Dalloshi, Ilirijana Berisha dhe Arbnora Kuka.

Nga KDI, mbledhja u monitorua nga Kijani Sallahu.

Nga niveli qendror, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, kuorumi me u mbajtur mbledhja ekziston, 1 anëtare mungon me arsye për shkak se ka dalë jashtë shtetit dhe nuk ka mundur me u kthyer për shkak të pandemisë. Ne jemi munduar me krijuar kushte pune në sallë, me distancë fizike për shkak të pandemisë, andaj hapi mbledhjen e III të Rregullt të Kuvendit të Komunës-respektivisht e katërta e rregullt për vitin 2020 për shkak se e kemi mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme në muajin mars, data 27 Maj, me këtë rend pune:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara të Kuvendit të Komunës:
 - Mbledhjes së II të Rregullt të datës 28 Shkurt 2020, dhe
 - Mbledhjes së Jashtëzakonshme të datës 26 Mars 2020;
2. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara në buxhetin e Komunës për në vitin 2020;
3. Propozim Vendim për Rialokim të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020;

4. Propozim Vendim për lirim nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2020, si dhe lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore deri në përfundim të Pandemisë COVID – 19; dhe
5. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të PK Nr. 00757-0, bujqësore arë e klasës 2, në pronësi të Azem Guri (bashkë posedim me sipërfaqe me 1/3) ZK Nikaj.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Rendin e Punës në përbërje prej 5 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara të Kuvendit të Komunës:

- Mbledhjes së II të Rregullt të datës 28 Shkurt 2020, dhe
- Mbledhjes së Jashtëzakonshme të datës 26 Mars 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Procesverbalet e dy mbledhjeve të fundit të KK janë futur me një pikë, ndërkaq do të votohen të veçanta. Materialin e keni marrë, nëse ka kush ndonjë vërejtje në Procesverbalin e mbledhjes së 2 të KK lë të urdhëroj; Vërejtje nuk ka, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së II të KK të datës 28 Shkurt 2020 e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e II-të (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2020 të datës 28 Shkurt 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-5392/20.

Nëse nuk ka kush diçka, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së I-r të Jashtëzakonshme të KK të datës 25 Mars 2020 e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e I-r (Parë) e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës për vitin 2020 të datës 26 Mars 2020 / Lënda: 01Nr.60/01-8927/20.

Pyetjet dhe Kërkesat

z. Nexhat Loku, Unë e kam një pyetje për Kryetarin e Komunës, Besim Ilazi, Nëse ka mundësi t'na jep sqarime të nevojshme se çka po bëhet me Çerdhen e fëmijëve në Kaçanik, kur dihet fakti se po qarkullojnë fjalë së çerdhja e fëmijëve është dhënë me qira.

Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, Unë po mundohem me dhënë sqarime të nevojshme në pyetjen e z. Nexhat Loku, për juve dhe për qytetarët e komunës. Në bazë të një Informate të cilën e kemi marrë ne të datës 18.05.2020, e kemi kuptuar nga inspektori i cili ka bërë pranimin teknik të objektit së Çerdhja e fëmijëve në Kaçanik-objektin e vjetër, është dhënë me qira me 16 prill nga ish drejtoresha e Çerdhes, Elife Murseli. Drejtori i DAK menjëherë iu ka përgjigjur me një shkresë firmës "BK" me pronarin Bashkim Topajani që mos me marrë veprime të nevojshme lidhur me çerdhen në fjalë, sepse janë bërë shkelje ligjore me marrjen e vendimit të kundërligjshëm të ish drejtoreshës. Me këtë vendim e kemi njoftuar, policinë e Kosovës për ruajtjen e objektit në fjalë dhe Gjykatën Komunale dhe kemi iniciuar padi ndaj

znj. Murseli për anulimin e kontratës së saj me “BK” Kaçanik. Znj. Elife Murseli, është larguar nga puna, me datën 23.04.2020 në bazë të vendimit të komisionit disiplinor, për shkak së e njëjta i ka larguar nga puna dy punëtore të Çerdhes së fëmijëve me një vendim të saj të kundërligjshëm.

Kryesuesi i Kuvendit, Faleminderit kryetar, Para se më kaluar në pyetjet tjera, iu njoftoj së unë e kam marrë një email nga z. Kijani Sallahu, i cili me njofton së në emër të KDI, do t'i monitoroj mbledhjet e Kuvendit të Komunës në vitin 2020. Kjo ishte sa për njoftimin e juaj, meqë mbledhjet e KK janë të hapura për OJQ dhe për qytetarë të komunës.

z. Adnan Reka,

1. Fillimisht po lidhem me çështjen e dhënies në shfrytëzim të Çerdhes së fëmijëve, cili është qëllimi që është dhënë me qira çerdhja e fëmijëve ?
2. Nga pakoja fiskale e ndarë komunave nga qeveria e Republikës së Kosovës në shumën 10 milion € për menaxhimin e situatës së pandemisë Covid-2019, me intereson të di, sa ka përfituar komuna jonë nga shuma e 10 milion euro dhe cili është planifikimi i shpenzimeve të mjeteve të përfituara nga kjo pako fiskale ?

Kryesuesi i Kuvendit, Për çështjen ndarjes së mjeteve buxhetore nga Kuvendi i Komunës për menaxhimin e pandemisë Covid-19 dhe përfitimet e komunës nga pakoja fiskale e ndarë nga qeveria e Republikës së Kosovës, besoj se ekzekutivi i komunës për mbledhjen e radhës së KK do të përgatit një Informatë për gjendjen pandemike dhe për shpenzimin e shumës 100.000€ për menaxhimin e pandemisë Covid-19 dhe për përfitimin nga pakoja fiskale e ndarë nga qeveria e Republikës së Kosovës. Në muajin qershor do t'i mbajmë dy mbledhje për me përmbushur Planin e punës së KK të vitit 2020.

Kryetari i Komunës, Çerdhja e fëmijëve në Kaçanik, nga Kontrata të cilën e kemi parë është dhënë në shfrytëzim për 15 vjet nga 645€, të cilat mjete do të përdorën për gastronomi etj. Kontrata e tillë është jo-valide, sepse dhënien në shfrytëzim të pronave komunale nuk mundet t'i jep as Kryetari e as drejtori, sepse janë procedurat e përcaktuara me ligj që përcaktojnë të dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Dhënia me qira e pronës komunale behët me Ankand publik, për këtë arsye kemi konstatuar së kontrata e tillë është antiligjore, sepse nuk janë përfillur procedurat që i përcakton ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

z. Bahri Selimi, Kur jemi të çështja e pakos fiskale e cila u përmend, të gjitha shpenzimet të cilat janë bërë deri me tani për menaxhimin e pandemisë Covid-19, janë me buxhet komunal. Si komunë deri me tani nuk kemi përfituar, ndërkaq sesa ka përfituar sektori privat, do të dal me një raport MEF.

z. Ekrem Kyçyku,

1. Në mbledhjen e II të rregullt të KK kam ngritur kërkesa, ndërkaq nuk kam marrë përgjigje, kështu që nuk do t'i përsëris më të njëjtat.
2. Kërkoj që Shtabi Emergjent për mbledhjen vijuese të sjell një Raport detaj lidhur me menaxhimin e situatës së pandemisë Covid-19.
3. Për këtë mbledhje kanë qenë të parapara edhe dy pikë me plan të punës së KK, ndërkaq të njëjtat nuk i kemi në rend pune. Njëra pikë është, Raporti i punës së DSHPE.

Kryesuesi i Kuvendit, Edhe pse nuk janë proceduar të gjitha çështjet sipas planit të punës së KK, besoj se ka arsye, kur dihet se administrata e komunës ka punuar me staf të kufizuar. Ftesa për mbledhje bëhet në bashkëpunim me ekzekutivin e komunës. Për shkak të gjendjes së pandemisë, kemi ngelur për një mbledhje prapa të cilën mbledhje besoj se do të mbajmë në muajin qershor dy mbledhje.

z. Ramadush Osmani, Lidhur me Raportin e punës që u përmend nga z. Ekrem Kyçyku, ndoshta është fjala për raportin e punës së KSHP e jo të DSHPE.

z. Ekrem Kyçyku, Kërkoj falje, Pika e cila është dashur me qenë në rend pune në këtë mbledhje ka të bëjë me Raportin e Punës së KSHP për vitin 2019 e jo të DSHPE.

z. Selim Reka, Unë Kam një kërkesë për ekzekutivin e komunës lidhur me një propagandë që po bëhet për një projekt që do të ndërtohet në liqenin e Ivajës. Ne duhet të mendojmë së se çfarë projekti duhet ndërtuar aty, me bërë një plan dhe me përkrahur atë projekt.

z. Nexhat Loku, Liçeni është i Kotlinës e jo i f. Ivajë.

z. Bekim Koxha, Përgjigjen të cilën ma ka dhënë DUKMM lidhur me dhënien e lejes ndërtimore për ndërtimin e pompës së benzinës e cila është ndërtuar në qytetin e Kaçanikut, nuk më është dukur përgjigje e mirë. Dhënia e lejes në atë lokacion për ndërtimin e objektit në fjalë është kundërligjore. Unë nuk besoj se ka ligj që lejon ndërtimin e pompës së benzinës në qytet. Me PZHK aty në atë pjesë është paraparë ndërtim urban e jo ndërtim të pompës së benzinës. Unë mendoj se kjo është shkelje flagrante e PZHK dhe Hartave zonale. Drejtori i DUKMM ka pasur një takim në Strugë për hartimin e PZHK. Drejtori duhet me na ofruar fakte që dëshmojnë së ndërtimi i objektit në fjalë –pompës së benzinës në qytet, duhet me u ndërtuar në atë lokacion.

znj. Arlinda Rakoci-Raka,

1. E kam një pyetje për DAK, Përse nuk po zhvillohet në komunën tonë si në komuna tjera mësimin online e nxënësve të komunës tonë përmes programit, Zoom.
2. Kam një Kërkesë për DSHPE nga banorët e lagjes së Re “Burim Rexha” për mungesën e ndriçimit publik në atë lagje, lagje kjo e cila kohë me parë ka pasur ndriçim publik, ndërkaq tani edhe pse popullata në këtë lagje është rritur dita ditës, mungon ndriçimi publik. Banorët e kësaj lagjeje janë të gatshëm më pasur një takim me organet relevante të komunës lidhur më këtë çështje.

znj. Hafize Sallahu, Sa i përket çështjes së liqenit i cili u përmend së donë më u ndërtuar një projekt në atë pjesë, liqenin nuk është as i Kotlinës e as i Ivajës. Për gjatë liqenit ka prona private të qytetarëve të Kotlinës dhe të Ivajës, ndërkaq nuk mundet me u ndërmarrë ndonjë veprim në atë pjesë për realizimin e ndonjë projekti pa u bërë shpronësimi i pronave private.

z. Agim Mani, Kam një Kërkesë nga banorët e f. Stagovë për një Peticion që e kanë ushtruar banorët e këtij fshati lidhur me demet që po ua shkakton një fermer nga fshati i Ivajë me vendbanim në Kaçanik të Vjetër, duke u shfrytëzuar kullosat e tyre në vendin livadhet e gata me mbi 350 krerë dele, me çka po ua mundëson pronarëve të pronave shfrytëzimin e pronave të tyre familjare. Kërkoj nga drejtoria e Bujqësisë të di së, a janë të regjistruara këto krerë dele në komunën tonë apo vijnë nga vendet tjera vetëm për t'i shfrytëzuar këto kullosa. Ka pasur raste edhe më herët lokacioni janë mbajtur dhi të cilat edhe kanë ngordhur, gjë që ka paraqet rrezik për qytetarët asaj ane për përhapje të ndonjë epidemie. Kërkoj të merren

veprime të menjëhershme nga organet relevante për këtë rast. Unë Peticionin e kam më veti dhe mundem të njëjtin t'ua dërgoj.

Kryesuesi i Kuvendit, Inicimi i procedurës së Peticionin bëhet nga drejtoria. Drejtoria është kompetente se a e dërgon në KK apo jo peticionin.

z. Shemsedin Luzha, Unë kam marrë një përgjigje nga DUKMM për çështjen e pompës së benzinës të ndërtuar në qytetin e Kaçanikut. Në përgjigjen e DU janë shënuar 6 çështje si arsyetim, që për mendimin tim janë të pakuptueshme, sepse nuk kemi të bëjmë me çështje shëndetësore siç shënon në arsyetimet e dhëna të kësaj drejtorie. Në vazhdim z. Luzha i lexoj arsyetimet e DUKMM të dhëna në përgjigjen e kërkesës së tij për çështjen e ndërtimit të pompës së benzinës në qytetin e Kaçanikut.

znj. Lirije Luta, Fillimisht e përgëzoj Kryetarin e Komunës dhe Shtabin e Emergjencës për aktivitetin e zhvilluar në menaxhimin e pandemisë Covid-19. Me intereson të ditur nga DAK, për përfundimin e procesit mësimor dhe forma e vlerësimit të nxënësve.

znj. Nazife Krasniqi, Me intereson të dijë për çështjen e autobusëve, a kanë me pasur qasje inspektorët për kontrollimin e tyre dhe a do të bëhet dezinfektimi i autobusëve.

Kryesuesi i Kuvendit, Çështja se si me vepruar kur të lëshohen në qarkullim autobusët, vendosë IKSHPK.

2. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara në buxhetin e Komunës për në vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Sqaroj për shumën e mjeteve të cilat do të bartën në vitin 2020 janë: 268.882.77€, e cila shumë pas bartjes, buxheti i vitit 2020 është në shumë, 9,269.412.77€. Mjetet e bartura do të shpenzohen për: Mallra e shërbime, 0.69€, 66,000€ për subvencione dhe transfere, ku nga kjo shumë, 50.000€ do të bartën OJQ "Jetimat e Ballkanit" për ndërtimin e shtëpive të banimit në komunën tonë si participim për një shtëpi 5.000€, ndërkaq për Investime kapitale shuma, 202,882.08€.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Shuma e mjeteve të cilat do të bartën 268,882.77€ është shumë e madhe, ndërkaq arsyetimi i dhënë së në muajt e fundit të vitit 2019 nuk mund të zhvillohen procedura tenderuese për projekte kapitale, nuk është arsye. Shuma 66,000€ nga Subvencionet dhe transferet nuk ka pasur arsye të bartën në vitin 2020, por të shpenzohen në vitin 2019 sepse nevojat e qytetarëve të komunës për subvencione janë të mëdha. Të pasqyrat tabelare e mjeteve të pashpenzuara të vitit 2018, shihet së 13,000€ kanë ngelë mjete të pa shpenzuara të nën programi, shërbimet e kujdesit primar shëndetësor, e që për mendimin tim nuk është në rregull me mjete buxhetore në këtë pozicion, kur dihen nevojat e qytetarëve të komunës për shërbime shëndetësore. Kjo të bënë më kuptuar së nuk është planifikuar mirë buxheti i komunës.

z. Ekrem Raka, Pyetje për drejtorin e DEFZH, Bahri Selimi, Të HVK nga programi buxhetor, Subvencionet dhe Transfere, a lejohen me u destinuar për shpenzim në ndonjë program tjetër shpenzues buxhetor apo duhet të shpenzohen vetëm për Investime kapitale.

z. Bahri Selimi, Shuma e mjeteve buxhetore, 268,882.77€ nuk janë shumë mjete që barten në pozicione tjera, kur dihet fakti se komuna në tre muajt e fundit inkasojmë mjete buxhetore, mirëpo nuk shpenzojmë. Nuk është puna së është keq planifikuar buxheti. Mjetet e ngelura buxhetore nga vitet e kaluara nuk shkojnë në suficit buxhetor, por i shpenzojmë ne si komunë. Të bartja e mjeteve buxhetore që po e bëjmë, na krijohet mundësia me shtuar mjete në secilin projekt kapital. Të pyetja e z. Ekrem Raka, alokimi i mjeteve buxhetore nga të HVK nga programi, Subvencione dhe transfere, bëhet për investime kapitale. Të bartja e mjeteve, aty ku mbesin mjetet aty alokohen. Në f.2. 152,919.00 € janë alokuar dhe nuk janë realizuar me kohë. Ne, në konsultim me ministrinë e kemi bërë propozim vendimin për bartjen e tyre. Të sektori i kulturës, për shkak të pandemisë, kemi mjete të aktiviteteve kulturore që nuk janë financuar disa aktivitete, kështu që kanë ngelur mjete buxhetore të pashpenzuara.

z. Ekrem Kyçyku, Mjetet buxhetore të cilat investohen në muajt e fundit është mirë me u planifikuar, ndërkaq nuk besoj së ekziston mundësia mos me u ekzekutuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 5 anëtarët nga LVV, Abstenuan 4 anëtarë; Ekrem Raka, Shemsedin Luzha, Bekim Koxha dhe Hafize Sallahi. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara të vitit 2019 në shumë 268.882.77€ në buxhetin e Komunës për në vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 400/01-9757/20.

3. Propozim Vendim për Rialokim të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020

Kryesuesi i Kuvendit, Ky Propozim Vendim ka pësuar një ndryshim nga ai që u shqyrtuar në KPF. Sqarime të nevojshme do të jep drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Të pika 1.2. në kuadër të nën-programit buxhetor – Shërbimet e shëndetësisë primare, nga projekti kapital, “Rindërtimi i objektit të QMF-së në fshatin Doganaj” shuma prej 30,000.00€, rialokohen në nën-programin buxhetor - Shërbimet e shëndetësisë, në projektin kapital “Blerja e veturave për nevoja të QKMF-së” shuma prej 20,000.00€ dhe në projektin “Furnizimi me mobilje dhe pajisje në QKMF” shuma prej 10,000.00€. Të pika 1.4, të Nën-programit buxhetor – Administrata Komunale, nga projekti kapital “Furnizimi me mobilje dhe pajisje” shuma prej 10,000.00€, rialokohen në nën-programin buxhetor – Administrata Komunale, “Blerja e veturave për A. Komunale” shuma prej 10,000.00€.

z. Ekrem Kyçyku, Të pika 1.2 të nën-programi, Shërbimet e shëndetësisë primare, nga projekti kapital, Rindërtimi i objektit të QMF në f. Doganaj, shuma e paraparë 30.000€, jemi kundër rialokimit të mjeteve buxhetore për blerjen e veturave të QKMF dhe furnizimin me pajisje dhe mobilje të QKMF, për shkak së është nevojë e f. Doganaj për rindërtimin e QMF.

Kryesuesi i Kuvendit, Shkolla e re në f. Doganaj, lokacioni do të caktohet të ambulanca, ndërkaq ambulanca do të ç vendoset në ndonjë lokacion tjetër. Ambulanca do të përcaktohet

në një lokacion të "Lushi". Në mungesë të lokacionit për ambulancë në Doganaj, edhe unë jam pajtuar që këto mjete të bartën për shfrytëzim në projekte të tjera, ndërkaq në vitin vijues do të parashihet mjete buxhetore për eksproprijim të pronave private për ambulancë sepse nuk ka prona shtetërore aty ku mendohet me u ndërtuar QMF në Doganaj.

z. Bekim Koxha, Edhe ne subjekti politik NISMA jemi për bartjen e mjeteve buxhetore, por në ndonjë projekt me prioritet, si fjala vjen në ndërtimin e trotuarit në rrugën: Doganaj-Koxhaj apo në ndriçimin publik në këtë pjesë. Sa për lokacionin për ambulancë në f. Doganaj duhet me gjetur një lokacion të përshtatshëm që i plotëson kushtet për ndërtimin e ambulancës.

z. Selim Reka, Ne subjekti politik i LDK kur është fjala për me investuar në projekte kapitale, jemi çdo herë Për lejimin e tyre.

znj. Nazife Krasniqi, Të pika 1.3 të Nën programi buxhetor, Shërbime publike, nga projekti kapital, Ndërtimi i rrugëve në f. Begracë, shuma 5.000€ riallokohen në programin buxhetor – Shërbime publike për projektin kapital, "Rregullimi i ndriçimit publik" Këtu është mirë më shënuar së ku bëhet ai ndriçim publik.

z. Bahri Selimi, Të pyetja e Nazifes, arsyeja pse barten mjete buxhetore nga një projekt në një projekt tjetër në vlerën nga 5.000€, është së bartën nga e njëjta drejtori. Mundësia është përmes DSHPE më intervenuar në ndonjë projekt për ndriçim publik.

z. Bekim Koxha, investimet publike nuk po shkojnë ashtu si propozohen në debate publike të organizuara me qytetarë të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Pjesa e rrugës të "Lushi" e magjistrale, është rrugë magjistrale, kështu që investimet bëhen nga ministria e infrastrukturës e jo nga komuna.

z. Shemsedin Luzha, Kur jemi të frekuentimi i rrugëve që u përmend f. Kaçanik i Vjetër, ua bëjë me dije së, rruga Kaçanik i Vjetër-Begracë është e njëjta rrugë, kështu që edhe Begraca është e frekuentuar njëjtë si Kaçaniku i Vjetër.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin anëtarët e LVV, Abstenoj Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për Rialokim të mjeteve buxhetore nga kategoria e investimeve kapitale –burimi i financimit Grant Qeveritar(10), sipas buxhetit të vitit 2020 / Lënda: 01Nr. 400/01-9755/20.

4. Propozim Vendim për lirim nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2020, si dhe lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore deri në përfundim të Pandemisë COVID – 19;

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo pikë na ka ardhur nga Kryetari i Komunës, kështu që për me arsyetuar të njëjtën, fjalën e ka Kryetrari i komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komuns- Besim Ilazi, Ky Propozim Vendim ka lindur si rezultat i pandemisë Covid-2019, duke pa gjendjen e rënduar të veprimtarive ekonomike që veprojnë në komunën tonë për shkak të mos funksionimit të tyre, të cilët paguajnë qira komunës, kemi menduar me

i liruar për vitin 2020, ndërkaq kemi liruar nga pagesa edhe shërbimet shëndetësore të gjithë qytetarët deri në përfundimin e pandemisë, për shkak të rrezikut nga infektimi me virus nga paratë e metalta.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Besim Vishi, Sa ndikon në buxhet shuma e mjeteve që do të inkasoheshin nëse nuk do të ishin liruar këto biznese dhe pagesat nga 1 € e shërbimeve shëndetësore.

znj. Hafize Sallahi, Këto biznese që po lirohen nga qiraja, besoj se kanë aplikuar edhe në pakon fiskale të qeverisë së Republikës së Kosovës të ndarë për komuna. Pandemia i ka goditur të gjitha bizneset, por jo të gjitha bizneset janë në prona të komunës.

z. Bahri Selimi, Bizneset të cilat nuk e kanë paguar qiranë komunës, nuk mund të aplikojnë në pakon fiskale.

Kryesuesi i Kuvendit, Ka arsye me u liruar nga qiraja bizneset, sepse bizneset janë dëmtuar mjaft për shkak të pandemisë dhe është i vështirë funksionimi i tyre edhe pasi të kaloj pandemia, ndërkaq çështja me vazhduar lirimet e qytetarëve nga shërbimet shëndetësore pas pandemisë, kujtoj se nuk ka logjikë.

znj. Hafize Sallahi, Unë propozoj të bëhet një ndryshim në Propozim Vendim, ashtu që edhe shërbimet shëndetësore të lirohen nga pagesa qytetarët e komunës deri në fund të vitit 2020.

Kryesuesi i Kuvendit, Qiraja është vjetore dhe nuk mundemi me ndarë. Ne jemi me i ndihmuat edhe bizneset tjera që veprojnë në pronat e tyre private, mirëpo duhet gjetur forma.

z. Bekim Koxha, Unë e përkrahi Propozim Vendimin për lirimin nga qiraja të bizneseve që veprojnë në prona komunale, deri sa të zgjatë pandemia.

Kryetari i Komunës, Të çështja e lirimit të bizneseve nga qiraja, qiraja është vjetore, ndërkaq nëse ju mendoni se duhet lirohen deri në përfundim të pandemisë, atëherë në rregull, ndërkaq të lirimi i pagesave shëndetësore është bërë deri në përfundim të pandemisë, duke llogaritur se paratë e metalta mund të infektojnë. Të çështja e bizneseve që veprojnë në pronat e tyre private, kjo varet nga pakoja fiskale nga niveli qendror sesa mund të përfitojnë.

z. Ekrem Kyçyku, Unë kërkoj që propozimi im që lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore të bëhet deri në fund të vitit 2020, të dal në votim për aprovim.

z. Bekim Koxha, Edhe jam me të njëjtin mendim me z. Kyçyku, që të lirohen pagesat e shërbimeve shëndetësore deri në fund të vitit 2020.

z. Selim Reka, Ne si LDK, cilido nga dy propozimet që do të votohet, do të përkrahim.

z. Nexhat Loku, Ne subjekti politik i PDK jemi për atë që fillimisht të dal në votim Propozim Vendimi bazë i Kryetarit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Rregull është që fillimisht të shtrohet në votim Propozim Vendimi ashtu si ka ardhur nga Ekzekutivi i Komunës. Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 7 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për lirim nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2020, si dhe lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore deri në përfundim të Pandemisë COVID – 19 / Lënda: 01Nr. 60/01-9754/20.

5. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të PK Nr. 00757-0, bujqësore arë e klasës 2, në pronësi të Azem Guri (bashkë posedim me sipërfaqe me 1/3) ZK Nikaj;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Kjo çështje është e rregulluar në formë decideve me Ligjin për destinimit të tokës bujqësore, ashtu që pala paraprakisht duhet të marrë Pëlqimin nga MBPZHR e pastaj Kuvendi i Komunës të vendosë mbi bazën e atij pëlqimi. Unë kërkoj që për këto çështje, paraprakisht të konsultoheni me ministrinë, ndërkaq më intereson të di, për sa vendime deri me tani është marrë Pëlqim nga ministria.

z. Ukshin Qallaku, Me PZHK ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore e menaxhojmë ne si komunë. 90% të rasteve ata nuk mundën me na refuzuar ndërrimet e destinimeve të tokës bujqësore, vetëm së i inkorporojnë në planin gjeneral. Ne si komunë jemi duke punuar në PZHK, i cili plan ka ndryshuar komplet.

Kryesuesi i Kuvendit, Ky Vendim shkon në MBPZHR, ndërkaq është çështje e ministrisë sesi e kthen përgjigjen, edhe pse ministria po i vonon shumë lëndët për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Vendimi është paraprak, DUKMM nuk mundet me dhënë leje ndërtimore pa e dhënë mendimin ministria.

z. Bekim Koxha, DUKMM nuk ka pasur të drejtë më dhënë leje ndërtimore as për pompën e benzinës në Kaçanik, por e ka dhënë lejen. Kjo drejtori me dhënien e lejes për ndërtimin e objektit-pompës së benzinës ka shkelur ligjin, ka dhënë leje edhe për çështjet që janë kontestimore me çka e ka dëmtuar buxhetin e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkoj nga z. Koxha që mos të dal jashtë temës. Atëherë meqë diskutime të tjera nuk ka, këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 11 votë Për, 6 votë Kundër, Abstenuan 5 anëtarë, ndërkaq 4 anëtarë nuk ishin në sallë kur u votua kjo çështje. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM PARAPRAK

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të PK Nr. 00757-0, bujqësore arë e klasës 2, në pronësi të Azem Guri (bashkë posedim me sipërfaqe me 1/3) ZK Nikaj / Lënda: 01Nr. 06-350/01-9350/20.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:30.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

Kemal Mërseli

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e III –të (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2020, mbajtur me 27 Maj 2020;

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 26.06.2020

Për: Anëtarët e Kuvendit/ znj. Arlinda Rakoci-Raka,
znj. Nazife Krasniqi

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejon t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë 27.05.2020, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

znj. Arlinda Rakoci-Raka,

Kam një Kërkesë për DSHPE nga banorët e Lagjes së Re "Burim Rexha" për mungesën e ndriçimit publik në atë lagje. lagje kjo e cila kohë me parë ka pasur ndriçim publik, ndërkaq tani edhe pse popullata në këtë lagje është rritur dita ditës, mungon ndriçimi publik. Banorët e kësaj lagjeje janë të gatshëm më pasur një takim me organet relevante të komunës lidhur më këtë çështje.

- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave ka inicuar kërkesën për procedurat e prokurimit të projektit "Rregullimi i ndriçimit publik". Pjesë e planifikimeve të drejtorisë për vitin 2020 është edhe rruga "Burim Rexha"-Kaçanik, ku planifikohet që të shtrihet rrjeti i ndriçimit publik. Posa të kryhen procedurat e nevojshme të prokurimit dhe lidhjes së kontratës do të fillohet me implementimin e projektit.*

znj. Nazife Krasniqi, Me intereson të dijë për çështjen e autobusëve, a kanë me pasur qasje inspektorët për kontrollimin e tyre dhe a do të bëhet dezinfektimi i autobusëve.

- Inspektori komunal i komunikacionit, në kuadër të kompetencave dhe detyrave të punës mbikëqyr dhe kontrollon linjat urbane dhe urbane periferike të operatorëve transportues të udhëtarëve me autobus dhe kombi bus, që operojnë në territorin e komunës së Kaçanikut. Në kuadër të kontrollave dhe inspektimeve që janë bërë nga Inspektori i komunikacionit është kompetencë edhe pastërtia e automjeteve transportuese të udhëtarëve, gjithashtu edhe pas shfaqjes së pandemisë Covid 19, duke ju referuar manualit të Ministrisë së Shëndetësisë është shfaqur nevoja obligative që operatorët transportues pas rifillimit të punës të bëjnë dezinfektimin e automjeteve (autobusëve dhe kombi bus), gjë që edhe inspektori komunal do të ketë qasje në kontrollimin lidhur me dezinfektimin e këtyre automjeteve të transportit publik të udhëtarëve.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,



Ramadush Osmani
Drejtor i DSHPE-s



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS

Përgjigje në pyetjen e znj. Arlinda Rakoci Raka: Përse në komunën tonë mësimi online nuk po zhvillohet si në komunat tjera përmes platformës Zoom?

Pandemia që ka përfshi tërë rruzullin tokësor ka sjellë probleme të mëdha në të gjitha sferat e jetës e edhe në arsim. Në vendin tonë personeli arsimor ka qenë totalisht i papërgatitur për organizimin e mësimi në distancë, prandaj MASHTI dhe DKA nuk kanë të drejtë të obligojnë mësimdhënësit të përdorin vetëm një platformë digjitale por ka rekomanduar përdorimin e çfarëdo platforme. Si në të gjitha komunat, edhe në komunën tonë janë përdorë mënyra të ndryshme të komunikimit me nxënës dhe prindër. Ka mësimdhënëse që kanë përdorë edhe platformën Zoom por jo të gjithë.

Përgjigje në pyetjen e znj. Lirije Luta: Më intereson të di nga DAK, për përfundimin e procesit mësimor dhe formën e vlerësimit të nxënësve.

MASHTI është kompetent për kalendarin shkollor dhe përfundimin e procesit mësimor, prandaj me 02.06.2020 është përcjellë në të gjitha shkollat Kalendari i përshtatur për përfundimin e vitit shkollor 2019-2020 në rrethana të pandemisë. Edhe për vlerësimin e nxënësve ekziston udhëzuesi i lëshuar nga MASHTI, me të cilin është i njoftuar çdo mësimdhënëse.

